

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT

MINISTRIA E FINANCËVE-MINISTARSTVO ZA FINANSIJE-MINISTRY OF FINANCE

Njësia Org. 02/MAPL Nr. Prot. 880-1/2026
Org. Jedinice Org. Unit Prot. No.

Nr. i faqeve 4 Data 08.05.2026
Broj stranica Datum
No. pages: Date:

PRISHTINË/PRISHTINA / PRISHTINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Financave - Ministarstvo Finansija- Ministry of Finance

Për:	Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës	
Kopje:	Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit të Komunës Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
Përmes:	Hysni Mehani, Zv. Ministër në Ministrinë e Financave Arton Ahmeti, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave	
Nga:	Bora Duli, Ud. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave	Date: 06.05.2026
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Referencë: 71/2026
Lënda:	Konfirmim i Ligjshmërisë	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuari Kryetar z. Bulliqi,
I nderuar Kryesues z. Shabani,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) - Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç paraqitet me nenin 9 dhe 10, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e komunës në vijim:

<i>Vendimi nr. 01-400/03-0024297/26, për shtim të buxhetit dhe kod të ri.</i>
<i>I miratuar më datë 23.04.2026</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 28.04.2026</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave më datë 04.05.2026</i>

Ministria e Financave (këtëj e tutje referuar si "**Ministria**"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Podujevës, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Podujevës, me anë të aktit administrativ komunal synon shtimin e buxhetit dhe krijimin e kodit të ri "Furnizim dhe Montimi i Serrave".
2. Në shqyrtimin e mundësisë së Komunës për realizimin e aktit administrativ komunal, Ministria ka konsultuar Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtëj e tutje referuar si "LMFPP") dhe Ligjin 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore 2026.
3. Parimi i përgjithshëm i mishëruar në LMFPP është se çdo organizatë buxhetore, në shpenzim të parasë publike, duhet të veprojë në përputhje me dispozitat ligjore të LMFPP-së, sikurse përcaktohet në nenin 3 të LMFPP-së.
4. Në përmbajtje të LMFPP-së, paratë publike përkufizohen si pasuri financiare ose para të cilat pranohen, janë nën përkujdesjen, mbahen në mirëbesim ose janë nën kontrollin e ndër tjerash, organizatave buxhetore.
5. Ndërsa, në kontekst të shpenzimit të parasë publike, neni 17 i LMFPP-së përcakton se shpenzimi i parave publike nga organizatat buxhetore mund të bëhet vetëm për qëllime të miratuara publike, si dhe nga fondet e ndara dhe të alokuara [theks i shtuar].
6. Nisur mbi këtë bazë, Ministria ka konsultuar Ligjin Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, saktësisht tabelën 4.1 ku është evidentuar se organizata buxhetore i ka të planifikuara shpenzimet e potencuara me aktin komunal për vitin 2026 fiskal.

7. Rrjedhimisht, akti administrativ i Komunës së Podujevës është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Podujevës dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, përkalazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave.

030-307/3
 04.05.2026



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT
 MINISTRIA E TËRHEQJESIA DHE STATISTIKË / MINISTRY OF FINANCE

Niveli Org: 02/MAPL No. Dreg: 880/2026
 Org. Iech: Org. Unit

No. i fazeve: 4, 05, 26
 Proj. shtetit: No. azget: Data

PRISHTINE / PRISTINA / PRISHTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Arton Ahmeti, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave	
Kopje:	Kryetari i Komunës së Podujevës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Podujevës Njësi për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor në MAPL	Date: 29.04.2026 -VI-020-307
Zyrtarët përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Maltin Shala, Zyrtar i Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit	
Lënda:	Shkresë përcjellëse për MF	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar vendimin nr. 01-400/03-0024297/26, për shtim të buxhetit dhe kod të ri, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Podujevës, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale.

Duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, nenin 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimi nr. 01-400/03-0024297/26, për shtim të buxhetit dhe kod të ri.

I miratuar më datë: 23.04.2026

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 28.04.2026

